

AKTIVITETET E ORGANIZUARA NGA DREJTORIA E INTEGRIMIT NË BE, PROJEKTEVE TË HUAJA DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

TAKIME & TRAJNIME ME TË RINJTË

- **Takim me përfaqësues të World Vision** për të diskutuar mbi punën e grupeve Impact në Kamëz dhe investimeve që organizata ka kryer në bashkëpunim me Bashkinë Kamëz në funksion të të rinjve.
- **Trajnim me të rinjtë mbi qasjet e politikave rinore** nga organizata “AlbaAccess Open” me të rinjtë e qytetit, nga ku u diskutua mbi standardet dhe qasjet e cilësisë së politikave rinore.
- **Trajnim me të rinjtë me temë “Aftësitë komunikuese dhe e folura në publik”** nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) në bashkëpunim me Deloitte Albania SH.P.K për anëtarët e KVR-së dhe të rinjtë aktivë të Bashkisë Kamëz.
- **Takim konsultues nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët** për procesin e rishikimit të Ligjeve nr. 75/2019 “Për Rininë” dhe ligjit nr. 45/2016 “Për Vullnetarizmin” me pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor, të rinjtë e grupeve Impact të krijuara nga World Vision dhe të rinj aktivë.
- **Workshop** me të rinjtë e gjimnazeve “Sfidat e perspektivat e mbështetjes së iniciativave me ndikim komunitar nga të rinjtë për të rinjtë”.
- **Seminar Social-Edukativ** “Të rinjtë për të rinjtë duke sfiduar barrierat në aktivitetet pro-sociale me fokus mbi çështjet që shqetësojnë ata”.
- **Trajnim me të rinjtë** në kuadër të projektit “Rinia Aktive për Politikën e Qëndrueshme”, organizuar në bashkëpunim me Bashkinë Kamëz dhe me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, me të rinj nga Shkolla Profesionale dhe Këshilli Rinor.
- **Trajnim me të rinjtë “Rinia Aktive për Politikën e Qëndrueshme”**, organizuar në bashkëpunim me Bashkinë Kamëz dhe me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë. U diskutuan çështje që lidhen me advokimin, lobimin, dhe organizimin në grupe informale, duke nxitur angazhimin aktiv të të rinjve në komunitet dhe bashkëpunimin me institucionet lokale për politika më të qëndrueshme.
- **Diskutim me të rinjtë dhe gazetari Blendi Salaj**, takimi u zhvillua në kuadër të muajit të letërsisë dhe përfshiu një bisedë letrare të hapur me të rinjtë. Ky aktivitet ofroi mundësinë që ata të diskutojnë rreth librit, kulturës dhe rëndësisë së letërsisë në jetën e përditshme.
- **Trajnim me të rinjtë:** Tema: “Zëri YPS – Të Rinjtë, Paqja dhe Siguria” me fokus paqen, konfliktet dhe përfshirjen rinore. Të gjithë pjesëmarrësit u pajisen me çertifikatë trajnimi që njihet dhe jashtë vendit.
- **Trajnim me të rinjtë:** Trajnimi “Menaxhimi i kohës, menaxhimi i konflikteve dhe puna e denjë” trajnim i dedikuar zhvillimit personal dhe profesional të të rinjve. Trajnimi synonte forcimin e disa prej aftësive kyçe të përditshmërisë dhe të mjedisit të punës.